



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS  
FAKULTETI I BIOTEKNOLOGJISË DHE USHQIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

**Lënda:** Kriteret për aplikimin dhe përzgjedhjen e studentëve në Ciklin e Parë dhe te Dytë për vitin akademik 2025-2026 në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit

**A. Kriteret e pranimit në Ciklin e Parë të Studimit, Bachelor**

a. Pranimi në programet e studimit të Ciklit të Parë të Studimeve, Bachelor është i mundur për çdo kandidat i cili ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm si dhe që plotëson:

- **Kriterin e meritës.** Nota mesatare e shkollës së mesme e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
- **Kriterin e rëndësisë** (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit).
- **Notën e lëndëve me zgjedhje**
- **Kuotat e paracaktuara** nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit

b. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në Ciklin e Parë të Studimeve bëhet duke u bazuar në formulën si më poshtë

$$A * K * 0.9 + B * 0.1$$

Ku: A = Nota mesatare e shkollës së mesme  
K= koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit  
B = nota e lëndës me zgjedhje

duke gjeneruar kështu një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj liste **brenda kuotave** të paracaktuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit për çdo program studimi.

## B. Kriteret e pranimit në Ciklin e Dytë të Studimeve, Master i Shkencave

a. Kanë të drejtë të **aplikojnë** për t'u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën “**Master i Shkencave**” studentet te cilet kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare “**Bachelor**”, “**Master Profesional**” në sistemin me kohë të plotë dhe të pjesëshme si dhe plotësojnë kriteret akademike si më poshtë:

- **kriterin e meritës.** Nota mesatare e ponderuar e studimeve të Ciklit të Parë (Bachelor), **të jetë 6.5 e lart.** Në rast se ka ende kuota të lira, nuk do përjashtohen aplikantët me mesatare më të ulët, por në asnjë rast më të ulët se **6.**
- **kriterin e rëndësisë** (koeficienti i profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit).
- **kuotat e percaktuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit.**

b. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në Ciklin e Dytë të Studimeve, Master i Shkencave do të bëhet duke u bazuar në formulën si më poshtë:

$$A * K$$

Ku: A = Nota mesatare e e ciklit të parë të studimeve Bachelor  
K= Koeficient sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet

duke gjeneruar kështu një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj liste **brenda kuotave** të paracaktuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit për cdo program studimi.

Koeficientët e profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit ne Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit për cdo program studimi janë si me poshtë:

- Kandidatët e diplomuar në Teknologji Agroushqimore, Teknologji Pijesh (Vreshtari-Enologji), Shkencat e Ushqimit, Bioteknologji Ushqimore, Kimi Ushqimore do të kenë koeficient **1.00**
- Kandidatet e diplomuar **jashtë profileve të studimit** që është bërë aplikimi koeficienti **0.90**

## C. Kriteret pranimit në Master Profesional

a. Kanë të drejtë të **aplikojnë** për t'u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën “**Master Profesional**” studentet që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare “**Bachelor**”, në sistemin me kohë të plotë dhe të pjesëshme si dhe plotësojnë kriteret akademike si më poshtë:

- **kriterin e meritës** (nota mesatare e ponderuar e studimeve të Ciklit të Parë të Studimeve, Bachelor).
  - **kriterin e rëndësisë** (koeficienti i profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit).
  - **kuotat e paracaktuara nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit.**
- b. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional do të bëhet duke u bazuar në formulën si më poshtë:

$$A * K$$

Ku: A = Nota mesatare e e Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor  
K= Koeficient sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet

- Kandidatet e diplomuar në Teknologji Agroushqimore, Teknologji Pijesh (Vreshtari-Enologji), Shkencat e Ushqimit, Bioteknologji Ushqimore, Kimi Ushqimore do të kenë koeficient **1.00**
- Kandidatet e diplomuar **jashtë profileve të studimit** që është bërë aplikimi koeficienti **0.85**

**DEKANI**  
**Prof.Dr. Kapllan Sulaj**

: